

INSPEKTORATI SHETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve Mars 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	03.03.2025	Kërkesë për vënie ne dispozicion të akteve	11.03.2025	Është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar	e plotë	0
2	07.03.2025	Kërkesë për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në mbetjet hidrokarbure të lëndës djegëse dhe vajit lubrifikues.	11.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj me email, ku kërkohet kryerja e analizave laboratorike për mbetjet hidrokarbure ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj, nëpërmjet kryerjes të analizave në laborator të akredituar, për sasitë e naftës dhe nënprodukteve të saj, sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999,” Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Ministrit nr.6 datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj procedurat dhe tarifat përkatëse", i ndryshuar. Për sa më sipër, ISHTI nuk kryen procedurat e marrjes së mostrave dhe analizimin e tyre në laboratorin e kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve për mbetjet hidrokarbure.	e plotë	0
3	12.03.2025	Kërkesë për kontaktin e një punonjësi të ISHTI për publikimin e të dhënave.	12.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj me email, në të cilën kërkohen të dhënat e personit të kontaktit në vijim të shkresës Nr.1535/1 Prot, datë 04.03.2025, ju bëjmë me dije se është pëcaktuar përfaqësusi i ISHTI.	e plotë	0
4	12.03.2025	Kërkesë për informacion nëse vazhdon të importohet Gazoil 0.1 %	12.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj me email, në të cilën kërkohet informacion, a vazhdon të importohet ende Gazoil 0.1%, ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj, nëpërmjet kryerjes të analizave në laborator të akredituar, për sasitë e naftës dhe nënprodukteve të saj të prodhuara në vend, të importuara, para zhdoganimi dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999,” Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe për të tretë. ISHTI për vitin 2024 dhe për periudhën 01.01.2025 deri më 12.03.2025 nuk ka marrë mostra për kontrol cilësor parazhdoganimit dhe në tregun e vendit tonë për produktin Gazoil ≤ 0.1 për përdorim industrial S SH UNI 6579:2011.	e plotë	0

5	13.03.2025	Kërkesë për informacion lidhur me procedurat për importimin e vajrave lubrifikantë dhe hidrokarbureve dhe pajisjen e subjektit me licencë dhe dokumentacionin lidhur me këtë veprimtari.	13.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, të dërguar me email, me datë 13.03.2025, në të cilin kërkonte të informoheni në lidhje me importimin e një sasive vajrash të makinave dhe hidrokarbure nga kompania juaj , ju informojmë si më poshtë: Bazuar në Nenin 14 të ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, ju bëjmë me dije se veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, të vendit a të importit, ushtrohet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë. Tregtimi me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera ushtrohet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, pasi të jenë pajisur me licencë tregtimi, sipas përcaktimeve të VKM nr.970, datë 02.12.2015 Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj (ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.4.2017).	e plotë	0
6	20.03.2025	Kërkesë për bashkëpunim për të evidentuar dhe konstatuar ligjshmërinë e ushtrimit të aktiviteve tregtare sipas fushave të përgjegjësisë.	25.03.2025	Janë vendosur në dispozicion emrat e inspektorëve që do të marrin pjesë në bashkëpunim.	e plotë	0